



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:058649

Datë: 13.06.2024

Numri i dokumentit: 05818489

2020:058650

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL, me gjyqtaren Hakile Ilazi me praktikanten e kësaj gjykate Altinë Maliqi, në çështjen penale kundër të pandehurit A.O. për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 313 par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.... të datës 27.05.2020, në praninë e prokurorit të shtetit Albert Zejnullahu dhe të akuzuarit A.O., pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik më dt. 03.06.2024, mori dhe publikisht shpalli, kurse me datë 13.06.2024 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: **A.O.** nga i ati N. dhe ëma S... e gjinisë H.i lindur me në Prishtinë. me vendbanim në B..., P.me numër personal 125.... i pa punë, i gjendjes se dobët ekonomike, Egjiptas, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:

Prej datës 05.03 2020 deri me 06.0.3.2020, në kohë të pacaktuar, në Rr. "K...Ferizaj- i pandehuri më qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme, vetit t'i sjell përftim pasuror në mënyrë të kundërligjshme. ka marrë pasurinë në marketin "M."-pronë dëmtuarit Y.A.. në atë mënyrë që kishte hvrë brenda dhe nga atv kishte marrë gjëra ushqimore, pashteta- akullore, sheqer si dhe ëmbëlsira dhe ishte larguar pa u vërejtur nga punëtorët e marketit. me ç 'rast të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm rreth 300 euro,-

me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja nga neni 313 paragrafi I Kodit Penal i Republikës së Kosovës.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 2, 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 46, 47, 48, 69 dhe 70, të KPRK-ës, si dhe në bazë neneve 364, 365, 449, 462 të KPP-ës,

G J Y K O N

- Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj si dhe dënim me gjobë në shumën prej 200 (dyqind) euro, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari brenda periudhës verifikuese prej 2 (dy) viteve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale, në të kundërtën do të revokohet dënimi me kusht.
- Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20/njëzet/€ në afat prej tridhjetë /30/ ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë.
- Obligohet i akuzuari që konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguajë shumën prej 20 €uro /njëzetë/, brenda afatit prej tridhjetë /30/ ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- I dëmtuari Y.A. me vendbanim në rr “.. në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m i

Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka ngritur aktakuzë PP.II.nr.458-1/2020 të datës 27.05.2020, kundër të akuzuarit A.O. për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 313 par.1 të KPRK-së.

Gjykata pasi vlerësoi se është në kompetencë lëndore dhe territoriale për ta gjykuar këtë çështje penale, si dhe pasi konstatoj se janë plotësuar kushtet ligjore që të mbahet seanca gjyqësore mbajti shqyrtimin gjyqësor fillestar me datë 03.06.2024 në të cilin shqyrtim morën pjesë prokurori i shtetit Albert Zejnullahu, i akuzuari A.O..

Pranimi i fajësisë nga i akuzuari

Pasi që gjykata e ka udhëzuar të pandehurin në kuptim të nenit 241 par.1 të KPPK-se dhe pasi që i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, në pajtim me nenin 241 par.3 të KPPK-së shqyrtimi fillestar ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi që gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar në tërësi aktakuzën, duke vepruar sipas nenit 241 par. 4 të KPPK-së i ka ofruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

I akuzuari A.O. me rastin e deklaramit lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilat është akuzuar, në shqyrtimin fillestar ka theksuar se e ndien veten fajtor dhe e pranon fajësinë, pranimin e ka bërë në mënyrë vullnetare duke qenë i vetëdijshëm për pasojat që mund të vijnë si rezultat i pranimit të fajësisë, duke shtuar se i vjen keq për këtë vepër penale, ka kërkuar falje, shton se është hera e parë që ka kryer vepër të tillë. Premton se nuk do të përsëris veprën penale dhe i propozuar gjykatës që ti shqiptoj një dënim sa më të ulët.

Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë

Prokurori i shtetit Albert Zejnullahu ka propozuar që të pranohet pranimi i fajësisë për të akuzuarin, pasi pranimi fajësisë është në përputhje me nenin 242 të KPPK-së, ky pranim është bërë në mënyrë vullnetare, i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe

ky pranim mbështetet në provat dhe faktet e çështjes që përmban aktakuza, i propozon gjykatës që të akuzuarit t'i shqiptoj një dënim në përputhje me dispozitat ligjore.

Vlerësimi i gjykatës lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari

Meqenëse i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtim fillestar, gjykata vlerëson se ky pranim është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtarja e vetme gjykuese konform nenit 242 paragrafit 6 të KPPK-së vlerëson se:

- i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë;
- pranimi bëhet vullnetarisht nga i pandehuri;
- pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit për plotësimin e aktakuzës të pranuar nga i akuzuari dhe çdo provë tjetër, siç është dëshmia e dëshmitarëve e paraqitur nga prokurori i shtetit ose i pandehuri dhe
- aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 242 par. 1 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi pranimin i fajësisë nga i akuzuari mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit si: Video-inxhizimet-CD-ja. të cilat gjinden në shkresat e lëndës.

Gjithashtu gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe masën e dënimit

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale Vjedhja nga neni 313 par.1 të KPRK-së, meqë me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar hollësisht në dispozitiv të këtij aktgjykimi i akuzuari me veprimet e tij në kundërshtim me dispozitat ligjore ka konsumuar elementet e veprës penale të lartcekur.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, faktin se i akuzuari nuk ka qenë i dënuar më parë me aktgjykim të formës së prerë për vepra të ngjashme penale. Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata gjeti shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i akuzuari ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale), si dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Shpenzimet e procedurës dhe kërkesa pasurore-juridike

Vendimi mbi shpenzimet paushallë është marr në kuptim të dispozitës së nenit 453 par. 1 lidhur me nenin 450 par. 2, nenpar.2.1 dhe 2.6 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05 L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të nenit 457 të KPPRK-së i dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest civil.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i përgjithshëm, Divizioni penal

2020:058650 datë 13.06.2024

Praktikantja

Altinë Maliqi

Gjyqtarja e vetme gjykuese

Hakile Ilazi

Numri i lëndës: 2020:058649
Datë: 13.06.2024
Numri i dokumentit: 05818489

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit nëpërmjet kësaj gjykate.